

VENDIM
Nr.841, datë 21.10.2010

**PËR KRYERJEN E PAGESAVE NË KUADËR TË MBYLLJES SË KONTRATAVE TË
FINANCUARA NGA PROGRAMET “PHARE” DHE TË MENAXHUARA NGA AUTORITETET
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit të kryejë pagesën, në shumën prej 17 000 000 (shtatëmbëdhjetë milionë) lekësh, në favor të Komisionit European, në kuadër të mbylljes së kontratave të financuara nga programet “PHARE”, të ndara si më poshtë:

- për programin “AL9803”, 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë;
- për programin “AL9914”, 5 500 000 (pesë milionë e pesëqind mijë) lekë;
- për programin “AL0007”, 8 000 000 (tetë milionë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga zëri “Investimet e parashikuara për kosto lokale, për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve”, për vitin 2010. Lista e projekteve, që preken nga pakësimi i fondeve është sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela 1

Entiteti i qeverisjes	Ministria e linjës	Kodi, institucioni	Emri i institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria ekonomike	Kodi i degës së thesarit	Kodi i projektit	Debiti	Emërtimi i projektit
			Pakësohet						17,000,000	
001	06	1006054	Drejtoria e Përgjithshme e rrugëve	03	04520	2310000	3535	M0620930	2,000,000	Kosto lokale supervizion ndërtim segmenti Fier-Vlorë (Levan-Vlorë)
001	06	1006054	Drejtoria e Përgjithshme e rrugëve	03	04520	2310000	3535	M062094	4,000,000	Kosto Lokale Projekti i Transportit Mirëmbajtje Tiranë-Kukës
001	06	1006054	Drejtoria e Përgjithshme e rrugëve	03	04520	2310000	3535	M062095	3,000,000	Kosto lokale projekti i transportit konsulencë
001	06	1006054	Drejtoria e Përgjithshme e rrugëve	03	04520	2310000	3535	M061560	3,500,000	Kosto lokale ndërtim rruga by pas Shkozet, Durrës
001	06	1006054	Drejtoria e Përgjithshme e rrugëve	03	04520	2310000	3535	M061563	4,500,000	Kosto lokale ndërtim nyja e Vorës dhe rrugët paralele
			Shtohet						17,000,000	
001	06	1006054	Drejtoria e Përgjithshme e rrugëve	03	04520	2310000	3535		17,000,000	Kosto lokale për pagesat e kontratave të financuara nga programi PHARE